



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 14 tetor 2013  
Nr.ref.:RK479/13

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin nr. KI25/13**

Parashtrues

**Qazim Dragusha**

**Kërkesë për vlerësim të procedurës civile në pritje në Gjykatën  
Komunale në Prishtinë, C. nr. 358/08 (zvarritje e procedurës)**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtrues i kërkesës është Qazim Dragusha nga Prishtina, i përfaqësuar nga Bejtush Isufi, avokat në Prishtinë. Parashtruesi i kërkesës është pronar i vetëm i NTPN 'Extradragusha', kompani private.

## **Objekti i çështjes**

2. Objekt i çështjes së kërkesës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata) është zgjatja e paarsyeshme e pretenduar e procedurës civile, e iniciuar nga NTPN 'Extradragusha' në vitin 2001, në Gjykatën Komunale në Prishtinë.

## **Baza juridike**

3. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës; nenet 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit, dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

4. Më 1 mars 2013, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës, Bejtush Isufi, avokat në Prishtinë, e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
5. Më 22 mars 2013, Kryetari e caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova si Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani.
6. Më 3 prill 2013, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës personalisht se kërkesa ishte regjistruar në Gjykatë. Me të njëjtën shkresë, parashtruesit i ishte kërkuar të dorëzojë dokumente shtesë në Gjykatë për ta mbështetur kërkesën, duke përfshirë të gjitha vendimet e Gjykatës. Gjykata gjithashtu e kërkoi autorizimin me shkrim se z. Bejtush Isufi është përfaqësues i autorizuar në Gjykatën Kushtetuese.
7. Gjithashtu, më 3 prill 2013, Gjykata njoftoi Gjykatën Themelore në Prishtinë në lidhje me kërkesën dhe kërkoi një kopje të vërtetimit të fletëdorëzimit, që tregon datën kur Vendimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, C.nr. 358/08, i 6 prillit 2012, i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës.
8. Më 17 prill 2013, z. Bejtush Isufi parashtroi në Gjykatë një kopje të autorizimit, të lëshuar nga parashtruesi i kërkesës.
9. Përveç autorizimit, vetëm dy dokumente, gjegjësisht Vendimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 699/2005, të 26 shkurtit 2008, dhe Vendimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 358/09, të 6 prillit 2012, i ishin bashkëngjitur parashtrësës me shkrim.
10. Më 30 prill 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë e informoi Gjykatën se rasti civil, C. nr. 358/08, i ishte dërguar Gjykatës Themelore në Prishtinë, dega në Podujevë, më 1 mars 2013.
11. Për më tepër, më 8 maj 2013, Gjykata e pranoi një letër nga Gjykata Themelore në Prishtinë, dega në Podujevë. Me atë shkresë, Gjykata u informua se Dega e Podujevës e kishte pranuar rastin civil, C. nr. 358/08, nga Gjykata Themelore në Prishtinë, më 6 mars 2013, dhe se rasti ishte regjistruar me numër të ri, C 98/13.



12. Dega në Podujevë e Gjykatës Themelore në Prishtinë gjithashtu ia dorëzoi Gjykatës një kopje të vërtetimit të dorëzimit, duke treguar se Vendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C. nr. 358/08, i 6 prillit 2012, i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 10 maj 2012.
13. Më 9 shtator 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Faktet e rastit**

14. Sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, më 11 janar 2001, kompania NTPN Extradragusha kishte paraqitur padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë duke kërkuar, *ndër të tjera*, njohjen e të drejtave të bashkëpronësisë, në shumën prej 55 % të pronës së paluajtshme (që përbëhet prej 72 lokaleve afariste) të Qendrës Tregtare "Urimi", e cila gjendet në Podujevë.
15. Ndonëse parashtruesi nuk ia kishte dorëzuar një kopje Gjykatës, si duket, më 19 tetor 2004, Gjykata Komunale në Prishtinë nxori Vendimin C. nr. 18/2001 dhe e shpalli veten jokompetente në pikëpamje territoriale për shqyrtimin e padisë së Extradragushës të vitit 2001.
16. Në një datë të paspecifikuar, Extradragusha ushtroi ankesë kundër vendimit për jokompetencë territoriale të Gjykatës Komunale në Prishtinë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë. Gjykata nuk ka marrë ndonjë kopje të asaj ankese.
17. Më 26 shkurt 2008, Gjykata e Qarkut në Prishtinë nxori Vendimin Ac. Nr. 699/2005 dhe prishi Vendimin C. Nr. 18/2001 të 19 tetorit 2004, duke ia kthyer rastin gjykatës së instancës së parë. Në arsyetimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut, thuhej se Gjykata Komunale e kishte bazuar vendimin e saj për jokompetencë territoriale në faktin se pala e paditur është banor i Podujevës. Sidoqoftë, Gjykata e Qarkut në Prishtinë gjeti se "*aktvendimi ankimor nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, sepse në nenin 9 të Kontratës mbi kryerjen e punëve në lokalet..., është paraparë se në rast të kontestit gjyqësor, gjykatë kompetente territoriale do të jetë Gjykata Komunale në Prishtinë*". Si rrjedhojë, Gjykata e Qarkut pohon se "*gjykata e shkallës së parë në riprocedurë do të veprojë sipas vërejtjeve...*"
18. Më 6 prill 2012, Gjykata Komunale në Prishtinë mori Vendimin C nr. 358/08 dhe e shpalli përsëri veten jokompetente në pikëpamje territoriale për të vendosur për rastin e Extradragushës. Ajo theksoi se pas plotfuqishmërisë së Vendimit, kjo lëndë, së bashku me shkresat e lëndës do t'i dërgohej Gjykatës Komunale në Podujevë, me kompetencë të gjykatës territoriale për rastin në fjalë.
19. Në arsyetim, Gjykata Komunale i referohet arsyetimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, në veçanti nenit 9 të Kontratës për kryerjen e punëve, por shtoi se në rastin civil të Extradragushës, duhet të aplikohen dispozitat relevante të Ligjit për procedurën kontestimore (LPK). Konkretisht, Gjykata Komunale i referohej nenit 41.1 të LPK-së sipas të cilit "*Për gjykim në kontestet lidhur me pronësinë dhe të drejtat sendore të tjera mbi sendet e paluajtshme, në kontestet për*



*shkak të pengim posedimit mbi sendin e paluajtshëm, si dhe në kontestet nga raportet e qiradhënies së paluajtshmërisë, ose nga kontratat për shfrytëzimin e banesave apo të lokaleve të punës, është ekskluzivisht kompetente gjykata në territorin e së cilës ndodhet paluajtshmëria.”*

20. Gjykata Komunale në Prishtinë shtjelloi më tutje se në pajtim me nenin 66.1 të LPK-së, *“Në qoftë se me ligj nuk është përcaktuar kompetenca territoriale ekskluzive e gjykatës për çështjen konkrete, palët mund të merren vesh që në shkallë të parë të gjykojë gjykata që nuk është me kompetencë territoriale, me kusht që kjo gjykatë të jetë me kompetencë lëndore.”* Përfundimisht, Gjykata Komunale arriti në përfundim se sipas nenit 3.3 të LPK-së, *“Gjykata nuk do t’i miratojë disponimet e palëve që janë në kundërshtim me:... b) dispozitat ligjore;...”*

### **Pretendimet e parashtruesit**

21. Parashtruesi në kërkesën e tij pretendon, dhe në veçanti në parashtresën me shkrim të 17 prillit 2013, si në vijim: *“Kanë kaluar më shumë se 12 vjet dhe gjykatat ende nuk e kanë zgjidhur çështjen e kompetencës për të shqyrtuar dhe vendosur në lidhje me këtë rast. Ka kaluar gati një vit dhe rasti ende nuk ka mbërritur në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Dega në Podujevë. Kanë kaluar më shumë 12 vjet dhe shqyrtimi meritohet i rastit ende nuk ka filluar dhe nuk është caktuar asnjë seancë e vetme....Edhe Qazim Dragusha ka të drejtë për një gjykim të drejtë lidhur me rastin me numër C. Nr. 358/2008.”*
22. Parashtruesi pretendon, edhe në kërkesë, edhe në parashtresën me shkrim të 17 prillit 2013, se në periudhën prej vitit 2008 deri më 2012, ai kishte dërguar shumë shkresa në Gjykatën Komunale në Prishtinë, urgjenca që ta shqyrtojë rastin. Megjithatë, Gjykata nuk ka pranuar asnjë shkresë.
23. Si rezultat, parashtruesi i kërkesës pretendon se ka pasur shkelje të nenit 22 dhe 31 të Kushtetutës si dhe të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
24. Parashtruesi i propozon Gjykatës *“ta shpallë kërkesën të pranueshme dhe të vërtetojë se ka pasur shkelje të nenit 12 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 6 të Konventës Evropiane për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut dhe të caktojë një shumë të caktuar të parave në emër të kompensimit të dëmit.”*

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

25. Në mënyrë që Gjykata të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, duhet që së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri të parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe Rregullore të punës.
26. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.1 të Kushtetutës, i cili parasheh:

*“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës, në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.*



27. Gjkata vëren që në fillim se edhe në kërkesë, edhe në parashtresën me shkrim të 17 prillit 2013, theksohej qartë se parashtrues në procedurën në Gjykatën Kushtetuese është Qazim Dragusha, e jo kompania Extradragusha, paditës në procedurën civile që është objekt i kësaj kërkesë.
28. Gjkata dëshiron të rikujtojë se sipas nenit 21.4 të Kushtetutës, "*Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme:*" (shih gjithashtu Aktvendimin në rastin Nr. KI. 41/09 AAB-Universiteti RIINVEST i 27 janarit 2010).
29. Gjkata rikujton se termi "viktimë" në nenin 34 të Konventës nënkupton personin e prekur drejtpërdrejt nga veprimi ose mosveprimi që është në shqyrtim (shih gjithashtu rastin *Eckle kundër Gjermanisë*, Aktgjykim i 15 korrikut 1982, Seria A nr. 51, p. 30, para. 66). Më tej, Gjkata rikujton se pa marrë parasysh personalitetin juridik të kompanisë për sa i përket çështjes së të qenit "person" i prekur drejtpërdrejt, do të justifikohet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, në veçanti, ku në mënyrë të qartë përcaktohet se është e pamundur për kompaninë për të aplikuar në Gjykatë nëpërmjet organeve të themeluara sipas neneve të saj të themelimit ose - në rast të likuidimit apo falimentimit - nëpërmjet likuiduesve të saj apo administratorëve në falimentim (shih *Agrotexim dhe të tjerët kundër Greqisë*, Aktgjykimi i GJEDNJ i 24 tetorit 1995, Seria A, nr. 330-A, p. 25, para. 66).
30. Gjkata vëren se parashtruesi është pronar i vetëm i kompanisë Extradragusha dhe prandaj ka interes personal për objektin e çështjes së kërkesës (shih *G.J. kundër Luksemburgut*, nr. 21156.93 para. 24, të 26 tetorit 2000).
31. Prandaj, Gjkata gjen se në rrethanat e rastit konkret, parashtruesi mund të deklarojë se është viktimë e shkeljeve të Konventës, që i prekin të drejtat e Extradragushës.

#### **Çështja e zgjatjes së paarsyeshme të pretenduar të procedurës civile në Gjykatën Komunale në Prishtinë**

32. Për qëllimet e procedurës në Gjykatën Kushtetuese, Gjkata vëren se procedura civile ndaj së cilës parashtruesi ankohet, kishte filluar më 11 janar 2001. Megjithatë, periudha e cila bie brenda juridiksionit të Gjykatës fillon më 15 qershor 2008, kur Kushtetuta hyri në fuqi (shih, *mutatis mutandis*, Horvat kundër Kroacisë, nr 51585/89 paragrafi 50, GJEDNJ-2001-VIII). Procedura në Gjykatën Komunale në Prishtinë, ndaj së cilës ankohet parashtruesi, kishte përfunduar më 1 mars 2013. Prandaj, një periudhë prej katër vitesh, tetë muaj e pesëmbëdhjetë ditësh bie për t'u shqyrtuar nga Gjkata.
33. Gjkata rithekson se në mënyrë që të përcaktohet arsyeshmëria e kohëzgjatjes në fjalë, duhet pasur parasysh gjendjen e rastit më 14 qershor 2008 (shih, ndër autoritete të tjera, rastin *Styranowski kundër Polonisë*, nr. 28616 / 95, § 46, GJEDNJ 1998-VIII).
34. Më tej, Gjkata rithekson se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të çështjes dhe duke iu referuar kriterëve të



vendosura nga praktika gjyqësore e saj, veçanërisht ndërlikueshmëria e rastit, sjellja e parashtruesit të kërkesës dhe të autoriteteve relevante dhe çfarë ishte në rrezik për parashtruesin në këtë kontest (shih, ndër shumë autoritete të tjera, *Frydlender kundër Francës* [GC], nr. 30979/96 paragrafi 43, GJEDNJ 2000-VII).

35. Gjykata vëren se në periudhën që do të merret parasysh, një vendim është marrë në rastin Extradragusha, gjegj. vendimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, më 6 prill 2012, dhe se pasi ai u finalizua së bashku me dosjen e lëndës së gjykatës, është dërguar në Gjykatën Komunale në Prishtinë, Dega në Podujevë, më 1 mars 2013, si gjykatë kompetente në pikëpamje territoriale, d.m.th. të njëjtën datë kur kërkesa është parashtruar në Gjykatën Kushtetuese.
36. Gjykata vëren që në fillim se duket të ketë pasur zvarritje në vendimmarrje për çështjen e juridiksionit territorial nga Gjykata Komunale në Prishtinë.
37. Gjykata rithekson se neni 6 paragrafi 1 u imponon shteteve kontraktuese që të organizojnë sistemet e tyre gjyqësore në një mënyrë të tillë që gjykatat e tyre të mund të përmbushin secilën nga kërkesat e tij, duke përfshirë detyrimin për të dëgjuar rastet brenda një kohe të arsyeshme (*Frydlender kundër Francës*, op. cit., paragrafi 45).
38. Sa i përket sjelljes së Extradragushës, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore në rastin Vasic (shih Aktvendimin për papranueshmëri, të 13 korrikut 2012) që i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si në vijim, "*Megjithatë, edhe në qoftë se gjykata kombëtare vetë është përgjegjëse për vonesat në procedurë, parashtruesi duhet ta ketë kundërshtuar atë në mënyrë që të provojë që për vonesat e panevojshme të mos mund të mbajë përgjegjësi ai vetë*".
39. Gjykata vëren se ndërsa parashtruesi pretendon se ai e kishte kundërshtuar zvarritjen në lidhje me periudhën prej 2008-2012, ai nuk i ka ofruar Gjykatës ndonjë dëshmi se ka shteruar të gjitha mjetet efektive juridike në dispozicion sipas ligjit të zbatueshëm në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës.
40. Gjykata gjithashtu vëren se i tërë kontesti i kompetencës territoriale ishte iniciuar nga parashtruesi dhe ishte zgjidhur përfundimisht më 6 prill 2012.
41. Duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e rastit, Gjykata konstaton se parashtruesi nuk e kishte mbështetur shkeljen e së drejtës së tij për gjykim të drejtë për shkak të kohëzgjatjes së paarsyeshme sa u përket procedurave civile gjyqësore në Gjykatën Komunale në Prishtinë.
42. Nga kjo rrjedh se kërkesa është qartazi e pabazuar, sipas rregullit 36 1. (c) të Rregullores së punës, e cila parasheh që "*Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa nuk është qartazi e bazuar*".
43. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa nuk është ngritur para Gjykatës në mënyrë ligjore në pajtim me nenin 1113 (1) të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) të Rregullores së punës, dhe si e tillë është e papranueshme

si qartazi e pabazuar pasi parashtruesi nuk e ka mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 113 (1) të Kushtetutës, nenit 48 të Ligjit, dhe në pajtim me rregullat 36 (2) (d) të Rregullores, njëzëri:

### **VENDOSI**

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe
- IV. TA SHPALLË këtë vendim të plotfuqishëm menjëherë.

**Gjyqtare raportuese**

Snezhana Botusharova



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Prof. dr. Enver Hasani